



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
I SANKSIONEVE

Data: 20.04.2021

Nr: 25

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 14, DATË 16.04.2021 TË KRYETARIT
TË BASHKISË VORË, Z. GENTIAN PICARI ME OBJEKT “KUNDËRSHTIMIN E
VENDIMIT NR. 234, DATË 14.04.2021 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË
ZGJEDHJEVE”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 20.04.2021, me pjesëmarrjen e:

Koli BELE - Kryesues
Elvin LAKO - Anëtar
Elvis ÇEFA - Anëtar
Ilijar RUSMALI - Anëtar
Ledio BRAHO - Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Kryetari i Bashkisë Vorë, z. Gentian Picari

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 14, datë 16.04.2021 të subjektit ankues kryetari i bashkisë Vorë, z. Gentian Picari me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 234, datë 14.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e denoncimit për moszbatim të vendimit nr. 140, datë 15.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndaj kryetarit të Bashkisë Vorë, z. Gentian Picari”.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 79 pika 1, 92, 123/1, 124, 126, 129, 134, 143 dhe 144 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenet 21, 30 dhe 31 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”



Rrethanat e çështjes:

1. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në datën 11.02.2021 është paraqitur një denoncim me shkrim nga Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) për shkelje të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas denoncimit të kallëzuesit LSI, pretendohet se: “Nga verifikimi i faqes zyrtare të Bashkisë Vorë, rezulton se kjo Bashki nuk ka një të tillë. Referuar parashikimeve në nenin 79, pika 1 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar dhe në nenin 7 pika 1 shkronja “c” të Vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Bashkitë duhet të përmbushin detyrimin për hapjen e faqes zyrtare me qëllim publikimin e detyrueshëm të parashikimeve të dispozitave të sipërcituara. Në këto kushte kërkohet ndërmarrja e hapave konkrete me qëllim që Bashkia Vorë të plotësojë këtë detyrim ligjor”.

2. Referuar denoncimit të mësipërm, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka kërkuar informacion Kryetarit të Bashkisë Vorë për masat e marra nga ana e tyre për plotësimin e kërkesave të parashikuara nga neni 79 pika 1 e Kodit Zgjedhor si dhe nenin 7, pika 1 shkronja “c”, të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ.
3. Në vendimin e tij, KSHZ arsyetoi se mosmarrja e masave të nevojshme brenda afateve të parashikuara për publikimin e vendimeve të Bashkisë Vorë për caktimin e vendeve për afishimin e materialeve propagandistike, ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Vorë, si subjekt i ngarkuar për zbatimin e këtij ligji.

Në këto kushte, KSHZ vendosi:

Kryetari i Bashkisë Vorë të marrë masat e menjëhershme për aksesimin e faqes së internetit për zbatimin e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

4. Pas marrjes dhe publikimit të Vendimit nr. 140, datë 15.03.2021 të KSHZ, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) është paraqitur një denoncim me shkrim, nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) për moszbatim të vendimit nr. 140, datë 15.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nga ana e kryetarit të bashkisë Vorë.

Sipas denoncimit të datës 29.03.2021, të subjektit politik LSI, pretendohet se: “Bashkia Vorë nuk ka zbatuar vendimin nr. 140, datë 15.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.”

5. Me datë 08.04.2021 ora 14:00, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve zhvilloi një seancë dëgjimore me palët në këtë proces administrativ.

Përfaqësuesi i palës së kallëzuar z. Gentian Picari në shpjegimet e tij, ka parashtruar se ka ndërmarrë të gjitha hapat që parashikon ligji për riaktivizimin e faqes së bashkisë Vorë, duke deklaruar se disponon të gjitha shkresat drejtuar agjencive të cilat krijojnë mundësinë e aktivizimit të faqes ëeb. Z. Gentian Picari pretendon se ka mbajtur korrespondencë elektronike dhe shkresore, pra një kronologji të gjitha shkresave, duke filluar nga data 06.01.2021, të cilat i ka adresuar me shkresën me nr. 333 prot., AKSH-it për suport teknik, AKEPIT dhe IKUB-it duke deklaruar se ende nuk ka marrë një përgjigje.

Përfaqësuesi i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim deklaroi se kryetari i bashkisë Vorë edhe pse ka pasur një iniciativë për të komunikuar me autoritetet përgjegjëse për hapjen e kësaj faqeje nuk ka pasur një vullnet të mirë për vënien në dispozicion të këtij informacioni.

6. Referuar komunikimeve me anë të email-it zyrtar ndërmjet Bashkisë Vorë dhe AKSHI-it çmohet se, faqja e web-it është në administrim të bashkisë Vorë. Kredencialet e serverit janë dhënë në momentin e krijimit të serverit dhe ato nuk zotërohen nga ana e AKSHI-it. Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, mospërmbushja e detyrimit nga kryetari i bashkisë Vorë, për hapjen e faqes së web-it të bashkisë Vorë, përbën shkelje të parashikuar 79, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, dhe nenit 7, pika 1, gërma “c” e Vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Për këto arsye, KSHZ vendosi me vendimin nr. 234, datë 14.04.2021:

Sanksionin administrativ me gjobë ndaj z. Gentian Picari, Kryetar i Bashkisë Vorë, në shumën 10.000 (dhjetë mijë) lekë.

7. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Kryetari i Bashkisë Vorë, që sqaron se faqja zyrtare e Bashkisë Vorë, bashkiavore.gov.al është dhuruar nga USAID nëpërmjet projektit STAR 2, pa një kontratë dhurimi, kurse hostimi i serverit te Agjencia Shqipëtare e Shoqërisë së Informacionit. Operatori zhvillues është IKUB.info që ka bërë të mundur ndërtimin e faqes dhe mirëmbajtjen e saj për 5 vite. Bashkia Vorë si institucion publik i vetëqeverisjes vendore aksesohet nëpërmjet browserit me emrin e domain-it: bashkiavore.gov.al dhe me kredencialet që janë dorëzuar nga operatori zhvillues ikub dhe USAID.

Bashkia Vorë sqaron se ky institucion nuk ka as server, as ndonjë pajisje fizike apo virtuale, por ata disponojnë vetëm kredencialet e dërguara nga AKSHI, me të cilat në momentin që tentojnë të lidhen, rezulton “Error Connection Lost”. Sipas subjektit ankues, problemi nuk ka ardhur nga Bashkia Vorë, por qëndron te serveri i hostuar nga AKSHI. Ankuesi sqaron se nga ana e bashkisë Vorë, është bërë edhe pagesa në datën 09.12.2020 për periudhën 11.01.2021-11.01.2026 e Domain, duke sjellë si provë faturën me nr. Serial 369932329.

8. Sipas subjektit ankues, pretendimi i subjektit politik LSI, se Kryetari i Bashkisë Vorë nuk ka patur vullnet të mirë, nuk qëndron pasi vullneti jo i mirë nënkupton mosveprim dhe neglizhencë, ndërkohë që është e qartë dhe e kuptueshme që nga ana e z. Picari janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për të patur aksesin e nevojshëm në faqen e uebit, madje në afat kohor përpara se të dilte vendimi nr. 140, datë 15.03.2021 i KSHZ-së.

9. Ankimi iu paraqit Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, i cili caktoi me short si relator z. Koli Bele. Në seancën e datës 19.04.2021, KAS-i me vendimin nr. 23, vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore. KAS caktoi seancën e shqyrtimit në datën 20.04.2021, në orën 17:00.

10. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi

- Vendimin nr. 234, datë 14.04.2021 të KSHZ;
- Procesverbalin e seancës publike të KSH për vendimin nr. 234/2021
- Udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të KSHZ “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjate fushatës zgjedhore”;
- Vendimi nr. 140, datë 15.03.2021 i KSH “Për shqyrtimin e denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9/2020 të Komisionit Rregulator ndaj Bashkisë Vorë”;
- Korrespondencën postare dhe elektronike të paraqitur si provë nga subjekti ankues
- Shkresën nr.1294/1 prot., datë 08.03.2021 nga Bashkia Vorë

- Shkresën nr. 2219/1 prot., datë 14.04.2021, me lëndë kthim përgjigje nga AKSHI;
- Vendimin të Këshillit të Ministrave, nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencie Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

1. Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë ka për qëllim caktimin e rregullave për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe referendumet. Ndër të tjera, objekt i rregullimit të këtij Kodi është edhe fushata zgjedhore e subjekteve si dhe media.

Ligji vendos disa garanci ligjore për të siguruar një proces zgjedhor të drejtë dhe të lirë, barazinë e subjekteve zgjedhore dhe për të siguruar që zgjedhësve të mos u komunikohen mesazhe zgjedhore të deformuara. Disa nga këto garanci janë: ndalimi i zhvillimit të fushatës zgjedhore në institucionet publike; detyrimi për transparencë të të ardhurave dhe shpenzimeve; afishimi i materialeve propagandistike në vende të caktuara dhe me shenja të dallueshme për të kuptuar qartë që këto materiale përdorën për fushatën e një subjekti zgjedhor etj.

2. Një nga detyrimet që ligji vendos për sa i përket fushatës zgjedhore, është edhe ai i parashikuar nga neni 79 i Kodit Zgjedhor, ku rregullohet mënyra e afishimit të materialeve propagandistike. Në pikën 1 të tij, ky nen parashikon se *“Jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, kryetari i bashkisë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, përcakton vendet publike në territorin e bashkisë përkatëse për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike. Vendet e caktuara duhet të jenë në ambiente që sigurojnë shikueshmëri publike dhe të kenë hapësirë të mjaftueshme ku të gjitha subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje të paraqesin programet e tyre zgjedhore dhe mesazhet zgjedhore. **Vendimi i kryetarit të bashkisë bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë menjëherë pas miratimit**”*.
3. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin. Pra, jo më vonë se data 21 Mars 2021 (35 ditë para datës së zgjedhjeve), kryetari i bashkisë, pasi të përcaktojë vendet publike në



territorin e bashkisë për afishimin e materialeve propagandistike, duhet ta publikojë këtë vendim në faqen zyrtare të internetit të bashkisë, menjëherë pas miratimit. Ky detyrim është i tillë për arsye të informimit të publikut dhe të subjekteve zgjedhore lidhur me këto vende afishimi.

4. Për rastin konkret të faqes së internetit të bashkisë Vorë, nga verifikimet e administratës në lidhje me ekzistencën ose jo të kësaj faqe ne ueb, rezultoi një link bashkiavore.gov.al/sq-al/Pages/default.aspx, por pa mundësi aksesi të mëtejshëm.
5. Me shkresën nr. 1466/1 prot., datë 03.03.2021, administruar pranë KQZ-së me shkresën nr.1294/1 prot., datë 08.03.2021, KSHZ është informuar se Bashkia Vorë ka një domain ekzistues të institucionit por ka humbur aksesin për përdorimin e tij. Nga shkresa rezulton e provuar se, Bashkia Vorë ka komunikuar nëpërmjet postës elektronike me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit si dhe IKUB, të cilat mirëmbajnë faqen zyrtare të Bashkisë Vorë, për të rimarrë faqen e institucionit në përdorim.

Agjencia Shqiptare e Shoqërisë së Informacionit me shkresën nr. 2219/1 prot., datë 14.04.2021, ka sqaruar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se: “Website i Bashkisë Vorë është ndërtuar si pjesë e projektit “Planning Local Government Project”. Ky është një projekt midis Bashkisë dhe operatorit ekonomik që ka fituar të drejtën e zhvillimit dhe implementimit të projektit. Në këtë rast ne kemi kontribuar në projekt duke vënë në dispozicion resurse infrastrukturore në formën e serverëve virtual të dedikuar, pra ne garantojmë vetëm kushtet optimale të resurseve infrastrukturore dhe komunikimit (kushtet e hostimit).” Sipas AKSH-it, përgjegjësia rreth përmbajtjes dhe shërbimeve që ofrohet nga këto servera është e Bashkisë Vorë.

6. Referuar vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencive Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, si dhe përmbushjes së detyrave funksionale të AKSHI-t mbi ofrimin e shërbimeve të përqendruara qeveritare, AKSHI garanton kushtet optimale të resurseve infrastrukturore dhe komunikimit (kushtet e hostimit). Nga administrata e KQZ-së u relatua se nga 61 bashki në Republikën e Shqipërisë, vetëm Bashkia Vorë nuk e ka përmbushur këtë detyrim.
7. Megjithëse subjekti ankues bashkia Vorë solli si provë një sërë mesazh elektronike të shkëmbyera midis specialistëve të saj të teknologjisë së informacionit dhe IKUB dhe

AKSHI, përsëri këto prova nuk konsiderohen të mjaftueshme nga KAS për të vërtetuar se kryetari i bashkisë Vorë ka zbatuar detyrimin e vendosur nga KSHZ në vendimin e tij nr. 140, datë 15.03.2021, ku i kërkohet kryetarit z. Picari marrja e masave të menjëhershme për aksesimin e faqes së internetit.

8. Në seancën publike të shqyrtimit të kërkesës ankimore, ndikuar edhe nga mosprezenca e subjektit ankues, nga verifikimi në vend i kryer nga administrata e KQZ-së nuk u arrit të provohej publikimi i vendimeve të bashkisë as në faqen zyrtare të bashkisë Vorë në *Facebook*.
9. Anëtarët e KAS shtruan për diskutim pyetjen nëse këto vendime të bashkisë Vorë ishin afishuar në këndin e afishimeve në territorin e bashkisë, por nuk morën përgjigje për një fakt të tillë, duke qenë se subjekti ankues nuk ishte i pranishëm në seancë. Në çdo rast, nga komunikimet shkresore, nga mbrojtja në seancën dëgjimore të KSHZ-së, nuk u soll asnjë provë që demonstronte vullnetin e Kryetarit të Bashkisë Vorë për përmbushjen e detyrimit sipas Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.
10. Një çështje tjetër që u ngrit gjatë zhvillimit të seancës publike të KAS ishte dhe lajmërimi i subjekteve zgjedhore me anë të e-mailit për vendimet e marra nga bashkia Vorë lidhur me përcaktimin e vendeve të afishimit të materialeve propagandistike, në mënyrë që subjekti ankues të vërtetonte vullnetin e mirë për të zbatuar fjalinë e fundit të pikës 1 të nenit 79 të Kodit Zgjedhor; mungesa në sallë e përfaqësueses së bashkisë Vorë nuk arriti ta vërtetonte një fakt të tillë.

PËR KËTO ARSYE

Për të gjitha arsyet e shtjelluara më sipër dhe mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe mbështetur në shkronjën “b” të pikës 1, të nenit 30, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KAS-i,



VENDOSI

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 14, datë 16.04.2021 të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Vorë, z. Gentian Picari;
2. Lënien në fuqi të vendimit nr.234. datë 14.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e denoncimit për moszbatim të vendimit nr. 140, datë 15.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndaj kryetarit të Bashkisë Vorë, z. Gentian Picari”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të shkallës së parë, Tiranë brenda 45 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Koli **BELE** - **Kryesues**

Elvin **LAKO** - **Anëtar**

Elvis **ÇEFA** - **Anëtar**

Ilirjan **RUSMALI** - **Anëtar**

Ledio **BRAHO** - **Anëtar**